



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T

**Nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 26. 05. 2020, në sallën e kuvendit me fillim në ora 14<sup>00</sup>**

### **Në mbledhje prezentuan:**

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

### **Të tjerë prezent:**

1. Latif Ramadani, DBF
2. Elmaze Behluli, DKA
3. Nazim Gashi, DMSH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se ju uroj qe të jeni mirë dhe keni kalu mirë pastaj tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

## **REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e KPF-së.
2. Raporti vjetor Janar-Dhjetor 2029,i punës së zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.
3. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2020.
4. Propozim rregullore për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.
5. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB-së

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh ekstraktit

Pasi që nuk pati plotësime as vërejte kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat për aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e KPF-së**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

## **Aprovoi**

### **Ekstraktin nga mbledhja e 22-të të KPF-së**

#### **Shtesë: Ekstrakti**

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se i kemi në rend dite edhe dy raporte por ne shkresë zyrtare nuk po kena, që mos me i shti në KPF.

Hyra Bytyçi, pasi që drejtori është prezent në seancë është mirë në pika të shkurta pak me na raportu.

Daut Azemi, propozoj që pika e dytë dhe e tretë të kalojnë në Kuvend.

Pastaj Kryesuesi e vuri ne votim propozimin dhe me 6 vota për dhe një apstenim kaloi kjo pikë

Pastaj u kalua në pikën e katër të rendit të ditës

## IV

### **Propozim rregullore për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behluli, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari,shpresoj që të gjithë jeni mirë po ashtu edhe familjet e juaja,një rregullore e mirëpritur nga gjeneratat e reja dhe shume domethënëse. Kërkoj një sqarim te drejtimit deficitare për cilat drejtime behet fjalë. Po ashtu do të ishte mirë qe ata qe përfitojnë bursë,te jene përfitues vazhdimisht. Po ashtu un kisha propozu qe të ishte ne vend të bursave kredi për student.

Lumturije Bytyqi, një rregullore e mirëpritur por në këtë rregullore nuk është përfshi se sa studentë do të përfitojnë. Do të është mire të ceket numri i studentëve qe do të përfitojnë e jo të lihet në dorë e kryetarit të komunës.

Albulena Kelmendi,ju uroj se pari festën e bajramit po ashtu ju uroj qe jeni të gjithë mirë. Një rregullore e mirëpritur për studentët e komunës së Lipjanit,shpresojmë qe të marrin bursat studentët të cilët e meritojnë. Te neni 9 pika 3 ku thuhet do të ketë kriteret shtese a ka mundësi një sqarim për cilat kriteret bëhet fjalë.

Hyra Bytyçi një rregullore e mirëpritur nga studentët por do të ishte mirë qe të ketë kriteret në bazë të meritës për studentët të cilët do të përfitojnë dhe të përfitojnë studentët të cilët e meritojnë.

Daut Azemi,te neni 9 te kriteret tjera shtesë është për qëllim për shembull vërtetimi i diplomës te noteri.

Ukë Kryeziu,kjo rregullore është mirëpritur nga të gjithë qytetarët. Do të ishte mire këtu te neni 2 pika 1 të bëhet në bazë të përqindjes së buxhetit e jo të lihet në dorë të Kryetarit të Komunës. Në e përkrahim këtë rregullore.

Elmaze Behluli,te drejtimet deficitare është parapa te jenë drejtimet siç janë gjuha gjermane,veterinaria drejtimet teknike etj.

Shuma e bursave për këtë vit do të jetë 40000 euro qe do të ndahen për 80 studentë nga 500 euro.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e rregullores dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim rregullorja t`i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

## V

### **Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB-s**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Nazim Gashi drejtor i DMSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu, a o nga e njeta organizatë Plolisi ky përfaqësuesi.

Afrim Miftari,para disa seancave në kuvend është diskutuar për disa anëtarë të KKSB-s qe nuk janë aktiv,a lidhen këto ndryshime me ato qe i kemi diskutua ne në kuvend.

Nazim Gashi,propozimet vinë nga komunitetet dhe ne nuk mund t'i ndryshojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,<sup>10</sup>

***Ekstraktin e hartoi***

***Behar Aliu***

***Kryesuesi i Komitetit***

***Daut Azemi***